**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni Rregullator**

Data: 20.4.2023 | Nr: 21 | Ora: 15:00

**VENDIM**

**PËR**

**NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronjat "a" e "b", dhe 3, nenit 22, pika 3, dhe nenit 36 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë vijon:
   a) në fund të shkronjës "a" të pikës 3, të nenit 5, shtohet fjalia si vijon:
      -"Të njëjtat masa merren edhe për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, sipas skemës tip, të planvendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

| | |
|---|---|
| **Ilirjana NANO** | **Kryetar** |
| **Arens ÇELA** | **Anëtar** |
| **Dritan ÇAKA** | **Anëtar** |
| **Helga VUKAJ** | **Anëtar** |
| **Muharrem ÇAKAJ** | **Anëtar** |

Skema Tip e planvendosjes së KQV-së për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore




*Figura 1 - Skema tip planvendosja për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore*

Miratuar me Vendimin nr. 21 datë 20.4.2023, të Komisionit Rregullator.